

---

## *Strategji për përmbushjen tatimore, për DPT-në, 2015-2019*

*Mjedisi ekonomik dinamik, përmbushja e pritshmërisë së tatimpaguesve dhe mbështetja Shqipërisë Europiane në proceset integruese, janë sfidat kryesore në vitet e ardhshme. Administrata Tatimore është e përkushtuar t'i përmbushë të gjithë objektivat, duke promovuar vlerat më të mira të saj*

---

---

### *Misioni*

---

Mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

---

---

### *Vizioni*

---

Arritja e një stadi ku të jemi administratë tatimore europiane në mbështetje të qytetarëve për rritjen e mirëqenies së tyre, duke luajtur plotësisht rolin tonë në proceset integruese europiane.

---

---

### *Vlerat*

---

Të jemi partnerë profesionistë për tatimpaguesit duke shërbyer me integritet, përkushtim, profesionalizëm, bashkëpunim, transparencë dhe etikë.

---

## *Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm*

---

Me ecjen përpara drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, qytetarët në Shqipëri presin, por edhe qeveria planifikon, një standard më të mirë jete për të gjithë shqiptarët. Përparim ka pasur, por një përmirësim i mëtejshëm i shoqërisë kërkon fonde për të financuar një sistem shëndetësor më të mirë, shkolla më të mira dhe infrastrukturë më të mirë. Këto fonde do të vijnë nga përmirësimet që do t'i bëhen sistemit tonë tatimor, ndërsa punojmë fort për të arritur standardet e një administrate tatimore që parashikohen në planet fiskale të BE-së. Këto plane janë udhëzime praktike që tregojnë se si funksionojnë më mirë sistemet tatimore evropiane. Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, arritja e standardeve të BE-së është një qëllim me rëndësi jetike. Përmes arritjes me sukses të këtij qëllimi, do të jemi më në gjendje ta përmbushim misionin tonë të rëndësishëm të financimit të buxhetit të vendit.

Strategjia e përmbushjes, që paraqitet në vijim, ndjek nga afër strukturën e përgjithshme të strategjisë së përgjithshme të organizatës sonë për periudhën 2015-2019, që është publikuar së fundmi. Kemi nevojë për një strategji më të hollësishme për zvogëlimin e evazionit fiskal në mënyrë që publiku, qeveria dhe punonjësit tanë të njihen me hollësi se si kemi menduar t'i zgjidhim problemet e përmbushjes tatimore me të cilat përballemi sot. Në veçanti:

- Do të fokusohemi tek sektorët më me risk të ekonomisë – në ato fusha për të cilat kemi të dhëna se nuk po paguhen detyrimet tatimore në periudhën në fjalë.
- Do të gjejmë këta sektorë me risk duke përdorur metoda moderne të analizës së riskut për të evidentuar sektorët dhe subjektet ku ka më shumë evazion fiskal.
- Për rastet e evazionit fiskal që bëhet me dashje dhe me paramendim, do ta ngremë drejtorinë tonë të hetimit të krimit tatimor me qëllim ndjekjen penale të atyre që janë raste të këqija.

Për tatimpaguesit e shumtë që bëjnë çmos t'i paguajnë detyrimet tatimore brenda afateve ne kemi plane për modernizimin e legjislacionit tatimor për ta bërë sa më të lehtë përmbushjen e detyrimeve tatimore. Këta tatimpagues do të përfitojnë edhe nga përmirësimi i shërbimeve, ndërkohë që e reformojmë mënyrën se si e menaxhojmë veten për të menduar dhe punuar më shumë si një biznes dhe për të qenë më në harmoni me nevojat e tyre. Sigurisht, kjo do të thotë që të kujdesemi për të rritur aftësitë dhe njohuritë e punonjësve tanë. Për të arritur këto qëllime të rëndësishme, na duhet ta përmirësojmë objektin dhe cilësinë e komunikimeve tona me tatimpaguesit sepse një e ardhme më e mirë varet nga një bashkëpunim dhe mirëkuptim reciprok.

Qëllimi i Planit Strategjik	Veprimi sa i takon përmbushjes	Rezultati i dëshiruar
<b>I – Kuadri për administrimin tatimor</b>	Të miratojmë në legjislacion dhe të zbatojmë një kuadër të përmbushjes vullnetare me stimuj për të mbështetur metodat me bazë riskun të trajtimit të evazionit fiskal.	Një kuadër ligjor që lejon përdorimin e plotë të modelit me risk të përmbushjes të BE-së, që mbështetet edhe nga FMN-ja
	Të planifikojmë të kemi një krah pune me aftësitë dhe predispozitat e duhura për të mbështetur menaxhimin e përmbushjes me bazë riskun	Aftësi të mjaftueshme për analizën e risqeve, analizën e të dhënave dhe kontrollin e të dhënave, për të mbështetur mënyrën e re të punës
	Të nxjerrim raporte tremujore për ecurinë e përmbushjes për drejtuesit e lartë të DPT-së dhe për qeverinë	Rezultatet e strategjisë së përmbushjes kuptohen dhe veprimet për përmbushjen përmirësohen sipas nevojës
<b>II – Fuqizimi i procedurave kyçe të punës</b>	Të korrigjojmë të gjitha kodet ekonomike për të mbështetur analizën e evazionit fiskal sipas sektorëve ekonomikë	Një paketë e kontrolluar dhe e korrigjuar e kodeve ekonomike
	Të vëmë në zbatim procedura të efektshme të rimbursimit tatimor të bazuara në risk, duke filluar me TVSH-në	Kërkesat korrekte për rimbursim paguhen menjëherë, ndërsa kërkesat e pavlefshme për rimbursim të zbulohen dhe hetohen
<b>III – Zbatimi i një qasjeje moderne për përmbushjen</b>	Të hartojmë procedura për informimin e tatimpaguesve, organeve përfaqësuese dhe agjentëve fiskalë lidhur me risqet e përmbushjes dhe planet për t'i luftuar ato	Bëhet deklarimi vullnetar i shkeljeve nga tatimpaguesit të cilët mund të përfitojnë nga kushte më të mira pa kaluar në kontroll tatimor
	Të fuqizojmë Drejtorinë e Riskut në përputhje me propozimet e miratuara në Komitetin e Menaxhimit të Përmbushjes të DPT-së	Burime adekuate për të ruajtur dhe zhvilluar një model risku të bazuar në rregulla dhe për ta futur me sukses në përdorim
	Të fillojmë përdorimin e versionit të parë të punës të modelit të riskut	Të fillojë projekti i parë përmbushjen bazuar tek fushat e identifikuara me risk
	Projektet e përmbushjes të bazuara në risk të përbëjnë 60 për qind të veprimeve për përmbushjen	Mbi analizën e riskut mbështetet pjesa më e madhe e veprimeve të përmbushjes duke u fokusuar tek e bizneset e duhura dhe pronarët e tyre
	Të zhvillojmë një strukturë të re për menaxhimin e borxhit dhe procese për të mbledhur tatimet në kohën e duhur	Të parandalohet krijimi i detyrimeve të reja të prapambetura dhe zgjidhen në mënyrë energjike detyrimet e vjetra të prapambetura duke përdorur sistemin e ri informatik
	Të rristrukturohet Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) në mënyrë që të jenë të qarta rregullat për përfshirje në DTM	Bazë e njëtrajtshme dhe procedura të miratuara për përfshirjen e subjekteve në DTM
	Të riorganizohet DTM në bazë të kritereve sektoriale për të lehtësuar menaxhimin e përmbushjes	Njohuri më të mira për mjedisin tatimor të subjekteve që mbulon DTM, shërbim më i mirë
	Qasje të kontrollit të tatimpaguesve për të përfshirë planet e trajtimit për risqet specifike dhe metodika të projekteve për të trajtuar risqet në të gjithë sektorin	Efektivitet më i madh i kontrollit tatimor dhe zbatim i njëtrajtshëm i metodikave standarde të projekteve

Qëllimi i Planit Strategjik	Veprimi sa i takon përmbushjes	Rezultati i dëshiruar
	Të hartojmë struktura dhe sisteme për hetim të përmirësuar të krimit tatimor	Gjykatat penale të dënojnë një numër të përshtatshëm kriminelësh fiskalë
	Të zhvillojmë shkëmbime të informacioneve me institucioneve të tjera shtetërore për të zbuluar krimin fiskal dhe operacionet e ekonomisë informale	Të identifikohen dhe zbatohen shkëmbimet e të dhënave të dëshirueshme.